



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 274/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Skenderaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Skenderaj, për shkak të vendosjes së flamujve mbi rrugët publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Skenderaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Skenderaj i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1050 (njëmijë e pesdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 17.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën pretendohet se me datën 16.10.2013, në Rrugën “28 Nëntori” dhe Rr. “Fehmi dhe Xhevë Lladrovci” në Skenderaj rreth orës 13:00, anëtarë të subjektit politik PDK, kanë vendosur flamuj mbi rrugë publike, ku me këtë veprim sipas parashtresit të ankesës janë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, neni 33 pika b) e LZP, dhe neni 3 pika b) e Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre.

Parashtresuesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi..

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 18.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.10.2013. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se pas marrjes se njoftimit për paraqitjen e kësaj ankese nga ana e LVV-së menjëherë ka ndërmarr veprime për ti larguar materialet zgjedhor ( flamujt ) te cilat ishin vendosur mbi rrugët publike, siç pretendohet në ankesë, përgjigjes në ankesë i janë bashkangjitur edhe fotografi me te cilat dëshmohet evitimi i shkeljes së supozuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se subjekti politik PDK ka vendosur flamuj mbi rrugën Rrugën “28 Nëntori” dhe Rr. “Fehmi dhe Xhevë Lladrovci” në Skenderaj, janë të qëndrueshme ngase konstatohen nga fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti i njëjtë politik ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe poashtu i njëjtë subjekt politik ka përsëritur në këto zgjedhje shkeljen e të njëjtës natyre.. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë flamujt nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti politik PDK shkelura rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që flamujt të PDK-së janë vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura në përgjigje të ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 274/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*